

Atentati në Vlorë/ Identifikohet autori, ja kush e plagosi 28-vjeçarin

Feb 10, 2017 | 20:17

SHPËRNDAJE

Facebook

Twitter

Identifikohet autori i atentatit të mbrëmshëm në Vlorë. Policia e Vlorës bën me dije se ka identifikuar autorin e plagosjes së shtetasit Arlind Lulushi, 28 vjeç, mbrëmjen e kaluar në qytetin e Vlorës.



I plagosuri Arlind Lulushi

“Autori i dyshuar është shtetasi Paris Sulejmani, 29 vjeç, banues në Vlorë”- njofton policia.

Sipas saj, ky shtetas është person me precedent penal të mëparshëm, i arrestuar më parë për veprat penale “Prodhim dhe shitje narkotikësh” dhe “Falsifikimi i vulave, stampave dhe formularëve”. Po punohet intensivisht për kapjen dhe arrestimin e tij.

Ngjarja

Arlind Lulushi u qëllua mbrëmë rreth orës 19:50 në lagjen “Isa Boletini”, pranë vendit të quajtur “Kali i Trojës”. Sipas Policisë, një person i paidentifikuar ende ka qëlluar me armë zjarri shtetasin Arlind Lulushi, i cili është plagosur në këmbë dhe ndodhet në Spitalin e Vlorës, në gjendje të rëndë.

Ngjarja ndodhi në të njëjtin vend si tre muaj më parë, ku i riu punon në një pikë bastesh. Pasi ka qëlluar me armë zjarri, autori është larguar duke përfutur nga errësira. Për t’i shpëtuar vrasjes, 28-vjeçari është larguar me vrap në rrugën kryesore, ndonëse i plagosur, por më pas ka rënë pa ndenja.

Ka qenë një mjet i rastit që e ka çuar me urgjencë në spital. Policia e Vlorës bëri të ditur se është përqendruar në disa pista, që nga hakmarja e mundshme, pasi djali i xhaxhait të tij është autor i një vrasjeje të dyfishtë në vitin 2015, deri te larja e hesapeve dhe konfliktet personale të vetë të riut.

Burime të Policisë bënë të ditur se në vitin 2011, Lulushi ka qenë i arrestuar për lëndë narkotike. Për këtë shkak, nuk përjashtohet dyshimi që ai të jetë implikuar në rrjet shitjeje apo trafikimi, por kjo pistë mbetet për t’u verifikuar. Gjithashtu, janë duke u verifikuar konflikte të tjera të tij, por Policia e Vlorës për efekt hetimi nuk bëri të ditur të dhëna konkrete.

Emri i Arlind Lulushit mësohet se lidhet dhe me një ngjarje të rëndë që tronditi dy vite më parë Vlorën, ku dy të rinj, një djalë dhe një vajzë, mbetën të vrarë pas të shtënave me armë.

Ngjarja ndodhi më 2 janar të vitit 2015. Ervis Lulushi (djali i xhaxhait të Arlind Lulushit) vrau me armë zjarri 21-vjeçaren Paola Bisha dhe kushëririn e saj, Parid Velaj, 28 vjeç. Ngjarja ndodhi për shkaqe xhelozie, pasi autori i kërkonte vajzës, studente në Gjermani, që të lidheshin së bashku. Në atë kohë, Policia shoqëroi Arlind Lulushin, i cili u akuzua si bashkëpunëtor i kushëririt të tij, Ervis Lulushi. Por ai u lirua për mungesë provash.

PANORAMA

© **Panorama.al**

Subscribe



Për t’u bërë pjesë e grupit të **"Panorama"** mjafton të klikoni: **Join Group** dhe kërkesa do t’ju aprovohet.

KOMUNITETI PANORAMA ONLINE:

<https://facebook.com/groups/panoramaonline/>

Kliko këtu për të shkuar te Panorama Sport

Shfaq komente

JU REKOMANDOJMË

boost



FOTO/ Nga Musolini, Hrushovi, Che Guevara, imazhet e rralla të 16 personaliteteve që vizituan

panorama.com.al



Vetitë që e bëjnë propolis kaq të rëndësishëm për shëndetin tuaj

Më Shumë

mjekesia.org

sponsorizuar nga **Iuvenis**

Ofertë e limituar, produktet Iuvenis me ulje deri në 70%




Super Anti-Aging...

ULJE, €25 nga €80




Kremi Anti Celulit

ULJE, €29 nga €80



Lotion An Celulit

ULJE, €29 nga €80




'Për mua Hygerta është më shumë Miss se sa gazetarë', Armand

panorama.com.al




6 hapa si të përmirësosh humorin tënd në shtëpi.

megateksa.com



Përcaktohen të gjitha grupet e Europa Ligës/ Milani “peshkon”

panorama.com.al



“Konferenca me pizhame”/ Zaganjori: Si u ribashkuan gjermanët pas 57 vitesh në një

panorama.com.al

Propolis i bletës suplimenti që mbështet sistemin tuaj imunitar


Më Shumë

mjekesia.org




Nga “pagat e luftës” tek “lufta e pagave”

panorama.com.al




Mercedes-Benz GLE e re: SUV më i mirë në llojin e saj

Mercedes-Benz Albania




Nuk ka mbrojtje për Nasho Jorgaqin

panorama.com.al




Mësoni sekretin e një fytyre pa rrudha

mjekesia.org



Ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës/ Kryeministri Rama jep lajmin e rëndësishëm: SHBA-të

panorama.com.al



Koha për të organizuar garderobën!

megateksa.com



'VOA: Çfarë ndodh në zgjedhjet presidenciale nëse një nga

panorama.com.al



Cili jeni ju, zoti Sorge?

panorama.com.al

E reja e madhe e programit Basha, përtej nevojës për të fituar zgjedhjet

Oct 3, 2020

FITIM ZEKTHI



Ujk kurrsesi, por as dele...

Oct 3, 2020

ZIJA ÇELA



Luftë ndaj krimit apo në shërbim të tij?

Oct 3, 2020

PËLLUMB NAKO



Fuga 100% e votës së qytetarëve, themeli i rikthimit të demokracisë funksionale

Oct 2, 2020

PIRO AHMETAJ



Diplomacia brilante e Kohl-Genscher për ribashkimin e Gjermanisë

Oct 2, 2020

BASHKIM ZENELI

